

NDERIM PËR ATA QË NA UDHËHOQËN NË RRUGËN E DIJES PËR NË EUROPE – MBRESA DHE FAKTE NGA BASHKËPUNIMI YNË ME ZVICRËN

ALEKO MIHO

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Biologjisë

Këtë shkrim ja kushtoj Prof. Reinhard Bachofen, nga Instituti i Biologjisë Bimore, Universiteti i Zyrihut, me rastin e Përvjetorit të lindjes, si një urim të përzemërt. Me këtë urim bashkohet edhe mirënjohja ndaj gjithë bashkëpunimit tonë tashmë prej 20 vitesh, me Prof. Bachofen dhe me shumë kolegë të tjerë zviceranë, të cilët nuk reshtën përpjekjet për të punuar sëbashku, për të dhënë kontributin e tyre për secilin prej nesh, përfshirë këtu edhe studentët tanë. Mirënjohje e thellë shkon edhe ndaj Fondacionit SNSF, por edhe shumë organizmave të tjerë për mbështetjen financiare në gjithë veprimtaritë tona. Është falë këtij bashkëpunimi në vite, me Zvicrën, Gjermaninë, Austrinë etj., që ne kemi mundur të ngrihemi, si në mësimdhënie dhe në kërkim, të rimëkëmbemi, të reformohemi institucionalisht, por dhe të kualifikohemi në karrierë shumë prej nesh.

Bashkëpunimi me Universitetin e Zyrihut ka qenë me rëndësi për disa nga institucionet tona në vite, dhe këtu Prof. Bachofen një pikë e fortë kyçe. Kjo nisi gjatë periudhës 2002-2004, në një projekt të përbashkët kërkimor për vlerësimin e cilësisë së ujërave në disa nga lumenjtë më të rëndësishëm dhe më të shqetësuar të Ultësirës Perëndimore Bregdetare. Ky bashkëpunim u zgjerua dhe thellua më shumë në gjatë periudhës 2006-09 për vlerësimin hidrologjik të pellgut të Bovillës. Të dyja këto studime janë mbështetur nga Fondi Kombëtar Zviceran për Shkencën (SNSF), si pjesë e programit SCOPES. Ato ishin shëmbull i mirë bashkëpunimi për grupet tona kërkimore të biologjisë dhe të kimisë në FShN, UT, me grupet të tjera në Universitetin Bujqësor, Impiantin e Përpunimit të Ujit të Pijshëm, Babru, dhe Universitetin e Zyrihut.

Si pjesë e këtyre studimeve gjithëpërfshirëse u mbrojtën 4 doktorata, 6 punime mikrotezash, rreth 10 publikime për lumenjtë, 15 për Bovillën, dhe mbi 40 kumtesa të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Rreth 20 specialistë dhe studentë kanë vizituar Zyriun dhe 5 kolegë zviceranë kanë vizituar Shqipërinë nga 1 javë deri në disa muaj për doktorantët. Po nën përkujdesjen e Prof. Bachofen dhe financimin e SNSF, në vitin 2013 u bë e mundur të botohesh 'Midis Tokës dhe Detit – Ekoguidë për të zbuluar ujërat tranzitore të Shqipërisë', botim monografik me ngjyra në gjuhën angleze. Si Ekoguida (2013) dhe përmbledhjet e dy studimeve për Lumenjtë e Ultësirës Bregdetare (2005) dhe për Bovillën (2009) janë të pranishme në faqen e FShN, UT (<https://fshn.edu.al/info/publikime-shkencore>).



Gjatë vizitës në Lumin Töss, Zyrih, Maj 2004. Në këmbë - nga e majta: H. Brandl, L. Kupe, A. Çullaj, R. Bachofen, A. Miho, F. Schanz; ulur nga e majta: P. Lazo, L. Pieshkazini, A. Hasko

Në këtë vazhdë, bashkëpunimi është shtrirë dhe në organizimin për vite me radhë (2014, 2017, 2018, 2019) të kursit praktik për ‘Monitorimin e Mjedisit’; rreth 1 javë zhvillohej pranë Qendrës së Biologjisë Alpine (CBA; <https://www.cadagno.ch>) në Piora, Bellinzona, dhe më pas rreth 1 javë në Zyrih; në këtë kurs kanë marrë pjesë mbi 60 studentë master të biologjisë së mjedisit dhe pedagogë, nga Shqipëria dhe Kosova.

Kursi përmbante një program intensiv, të pasur me çështje shkencore dhe praktike me interes për ne shqiptarët, krahas shumë çështjeve me karakter shoqëror. Në CBA trajtoheshin në grupe të vogla çështje për bimësinë alpine dhe hidrologjinë e luginës së Piorës, gjeologjinë dhe faktorët mjedisorë, meromiksinë e liqenit Cadagno, shtresat mikrobike, likenet, invertebrorët etj., shoqëruar këto me eskursione praktike në këtë luginë në lartësinë mbi 2000 m mbi nivelin e detit.

Gjatë qëndrimit në Zyrih bëheshin vizita të drejtuara në impiantet e Përpunimit të Ujit të Pijshëm, të Trajtimit të Ujërave të Zeza dhe të Trajtimit të Mbetjeve Organike dhe Prodhimit të Biogazit, në Kopshtin Botanik, në Stacionin Limnologjik të Universitetit të Zyriut etj. Një informacion më të hollësishëm për këtë lexuesi mund ta gjejë në opinionin që unë kam shkruar në botimin e fundit të CBA të Peduzzi & Bianconi (2021), f. 85; <https://www.cadagno.ch/Bereich-Dokumente>.

Në gjithë këtë bashkëpunim me Zvicrën, përpjekjet dhe pasioni i palodhur dhe përkushtim që nga hartimi fillestar i propozimeve tona për programin SCOPES në vitin 2002, te ndjekja me kujdes e tyre e deri tek ndihma

profesionale hap pas hapi për të dhëna sa më të sakta dhe të besueshme. Përkujdesja ka qënë e madhe për pajisjet e reja sa më cilësore, për kualifikimin e stafit në Zyrih, sidomos i të rinjve në doktorim e sipër. Profesori nuk ka përtuar dhe reshtur ende të mbledhë dhe të dërgojë falas në Tiranë pajisje, qelqurina dhe literaturë. Një kamion i madh me rimorkjo, ka ardhur 5-6 herë në Tiranë, i mbushur plot dhe me mobilje laboratorike, duke plotësuar nevoja ndonjëherë edhe të ngutshme në institucionet tona, si FShN, UT, Universitet Bujqësor dhe gjetkë. Edhe sot ne kemi në përdorim pajisje, literaturë, madje dhe mobilje të siguruara nga ky bashkëpunim i gjatë në vite.



Foto e grupit të studentëve, pedagogëve nga Shqipëria dhe Kosova, dhe e bashkëpunëtorëve nga Zvicera, në Qendrën e Biologjisë Alpine (CBA; <https://www.cadagno.ch>), Piora, Bellinzona, në Gusht 2018.

Pavarësisht moshës, Prof. Bachofen nuk ka përtuar të ndjekë grupet tona në terren, në lumenj, në Bovillë, në Theth, në Rivierën shqiptare, në Lurë etj. Kujtojmë me emocion atë që ndodhi në Lurë në prill 2013, gjatë ekspeditës me studentët tanë të Biologjisë së Mjedisit. Gjithë pjesa e Parkut ishte e mbuluar me dëborë, dhe liqenet në gjendje të ngrirë. Prof. Bachofen thyen këmbën, duke zbritur me grupin nga Liqeni i Madh për tek kamioni, i cili na priste më poshtë, për të na çuar në hotel në Fushë Lurë.

Këtë ndodhi ai e përballoi me shumë burrn duke na dhënë kurajo dhe ne të tjerëve. Këtu vlen të përgëzoj për përpjekjet kolegët e mi, Prof. L. Shuka dhe Prof. F. Bego, studentët e vitit të dytë të kursit të Biologjisë së Mjedisit të atij viti, por dhe gjithë vendasit nga Fushë Lura, të cilët nuk munguan të na vinin menjëherë në ndihmë. Por e gjitha ndoshta nuk do kishte përfundimin e dëshiruar pa gadishmërinë e shpejtë të Shërbimit me helikopter nga Tirana, dhe mjekët e Spitalit të Traumës, të cilët na erdhën menjëherë në ndihmë, dhe për 1 orë e 30 minuta Profesori ishte në Tiranë nën kujdesin e tyre. Gjej

rastin të ritheksoj falënderimin për dy kolegë dhe miq të mirë që me gadishmërinë e tyre na u gjendën pranë, Prof. M. Tafaj, në atë kohë zëvendës kryeministër dhe ministër i Arsimit dhe Shkencës, dhe Prof. H. Kosova, në atë kohë ministër i Shëndetësisë. Faleminderit shumë për sa bëtë atë ditë! Faleminderit si në emrin tonë dhe të Prof. Bachofen! Falë kësaj gadishmërie të pashembullt dhe jo të lehtë për zonën ku ndodheshim, Profesori i shpëtoi këmba! Madje në korrik 2014 ai ishte në Alpet Zvicerane për 10 ditë bashkë me një grup pedagogësh të rinj dhe studentësh nga Tirana në një kurs të biologjisë alpine.

Në vitet në vijim bashkëpunimi ynë ka pësuar një zbehje kjo sidomos edhe prej pandemisë Covid 19, por nuk kanë munguar kontaktet mes nesh, dhe sidomos interesimi i Prof. Bachofen për t'u gjendur pranë dhe për të ndihmuar, përfshirë këtu edhe pajisje, libra, publikime etj. Duhet thënë se ky bashkëpunim ka kërkuar ndër të tjera edhe shumë durim, duke pranuar shpesh edhe huqet tona, edhe vështirësitë e kohës, herë objektive, por në shumë raste edhe subjektive, që buronin nga paaftësia apo nga mendësitë tona të cinguar.

Ky ishte rrëfimi im i përmbledhur, por tepër i singertë, për këtë Mik të shtrenjtë, gjithë bashkëpunëtorët dhe gjithë mbështetjen financiare zvicerane në vite. Në 11 Korrik 2022, Profesori pati ditëlindjen e 90-të. Me këtë rast i urojmë nga zemra jetë të gjatë, plot shëndet dhe përherë gjallëri, kjo dhe në emër të gjithë kolegëve të mi bashkëpunëtorë në vite dhe shumë studentëve. Le të jetë ky rifreskim i bashkëpunimit tonë edhe si një frymëzim dhe nxitje për t'u ndjekur më tej nga brezat e rinj.